



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.04.2019

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në disa shkolla të qytetit të Fierit, në Parkun Arkeologjik të Apollonisë dhe në Manastirin e Ardenicës.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Bujar Çela, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Prezent:

Armando Subashi – Kryetar i Bashkisë Fier,

Yllka Beci - drejtore e Drejtorisë Arsimore të Fierit,

Astrit Hasani - drejtor i Teatrit “Bylis”,

Arian Dhimo - nëndrejtor i Parkut Arkeologjik të Apollonisë,

Përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Procesverbal i përmbledhur

Milva Ekonimi - Komisioni ynë, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, sot do të zhvillojë një vizitë pune në qytetin e Fierit, ku fillimisht do të njihemi me investimet në disa shkolla, si dhe me implementimin e programeve, si “Shkolla qendër komunitare”, “Bëj detyrat e shtëpisë”, “3 lëndë në 6 orë”. Më pas, do të vijojmë me një vizitë në teatrin “Bylis” të qytetit, i cili është drejt fundit të rikonstruktimit, në Galerinë e Arteve “Vilson Kilica”, në Parkun Arkeologjik të Apollonisë dhe në Manastirin e Ardenicës. Pra, do të jetë një vizitë e nderthurur midis arsimit dhe kulturës, fusha që mbulon komision ynë.

Në këtë vizitë, po na shoqërojnë kryetari i Bashkisë së Fierit, zoti Armando Subashi, dhe drejtorja e Drejtorisë Arsimore, zonja Yllka Beci.

Adelina Rista – Këtu jemi në Fier. Unë si deputete e Fierit dhe mësuese në profesion, kam shërbyer 24 vjet në mësimdhënie, ndihem mirë që sot kemi ardhur si komision parlamentar për vizitë në shkollat e Fierit, për të parë nga afër gjithçka ka ndodhur me arsimin profesional në qytetin e Fierit pas reformës në arsimin parauniversitar. Do të vizitojmë nga afër disa shkolla, ku dhe do të prekim ndryshimet që janë bërë në infrastrukturë. Meqë këtu është prezent edhe kryetari i bashkisë, dua ta falenderoj atë, sepse u ka qëndruar mbi kokë të gjitha punimeve që janë bërë për rikonstruksionin e shkollave.

Siç e shikoni edhe ju, shkollat e Fierit janë model për sa i përket infrastrukturës. Shembull për këtë është shkolla “Dino Ismaili”, në Levan. Në këtë shkollë unë kam filluar punë për herë të parë si mësuese dhe kam shërbyer 4-vjet. Dikur ka qenë shkollë e mesme, kurse sot është vetëm shkollë 9-vjeçare. Siç po shikoni këtë shkollë të rikonstruktuar, të bukur dhe me punime cilësore, kështu janë të gjitha shkollat në bashkinë e Fierit. Kjo shkollë, e cila ndodhet në njësinë administrative Levan, bashkia Fier, ka cilësi të veçanta, sepse vetë Levani ka një komunitet të përzier për sa i përket kulturave dhe jeton në harmoni të plotë. Këtu gjen njerëz nga shumë treva të Shqipërisë; myzeqarin, mallakastriotin, tepelenasin, gjirokastritin, komunitetin rom, që është me shumicë. Kjo shkollë ka një numër të konsiderueshëm nxënësish nga komuniteti rom. Nga 350 nxënës që ka sot shkolla, 120 prej tyre i përkasin komunitetit rom. Gjithashtu, kjo shkollë i shërben edhe komunitetit, sepse në bazë të reformës në arsim

shërben edhe si qendër komunitare. Ka një kolektiv pedagogjik të specializuar sipas lëndëve që jepen në shkollë dhe standard cilësor.

Pas shkollës së Levanit, do të vizitojmë shkollën e mesme industriale “Petro Sota”. Kjo shkollë ka qenë me emër në qytet, të cilin e humbi në fillimet e demokracisë, por po e rifiton përsëri emrin e humbur. Faktikisht, ajo u bë një konglomerat degësh, sa u arrit të futeshin edhe klasat pedagogjike. Nga shkollë industriale me degët mekanike, elektrike, hidroelektrike, degë për naftën, ku dilnin motoristë, xhenerikë, pra, të gjitha profesionet mekanike, u arrit të hapeshin klasat e arsimit të përgjithshëm dhe klasat e arsimit pedagogjik, dhe shkolla humbi identitetin dhe fuqinë e saj si shkollë e mesme profesionale. Tashmë, pas reformës në arsimin parauniversitar, ne i shikojmë nga afër rezultatet që ka arritur kjo shkollë për sa i përket infrastrukturës, pajisjes me laboratorët përkatës, por edhe për sa i përket bazës së praktikave profesionale. Kjo shkollë, përveç praktikave profesionale që zhvillon në bizneset që veprojnë në zonë, me të cilat është lidhur, zhvillon praktika edhe në laboratorët e saj. Për kuriozitet, dua t’ju them se kësaj shkolle i janë bashkëngjitur edhe dy klasa të specialitetit të naftës.

Përveç shkollës “Petro Sota”, bashkia e Fierit, me të ardhurat e veta dhe në bashkëpunim me qeverinë, ka filluar rikonstruksionin edhe të shkollës artistike dhe është në përfundim të punimeve. Ka dalë një shkollë model për sa i përket investimit, të cilës i është bashkëngjitur edhe salla e re e baletit. E përmenda shkollën artistike në mes të diskutimit, për të thënë që nxënësit e shkollës profesionale “Petro Sota” po bëjnë instalimet në shkollën artistike. Domethënë, atë që mësojnë në teori dhe në praktikë të shkolla, e zbatojnë në praktikë në shkollën artistike, bëjnë praktikë profesionale. Kjo është një gjë shumë e mirë.

Në vijim është edhe shkolla “Andon Xoxa”, që është shkolla nr. 1 e qytetit. Përveç emrave, shkollat kanë edhe numra, sipas rajoneve. Kjo është shkolla nr. 1 e qytetit dhe është në qendër të tij, është shkolla më e vjetër, që mirëmbahet dhe rikonstruktohet për t’i ruajtur identitetin. Ajo nuk ka dalë nga struktura e saj, përveç disa shtesave që i janë bërë. Dikur, në fëmijërinë time, kjo shkollë ka qenë shkollë artistike, sepse ka pasur klasat e muzikës, por edhe klasat e basketbollit dhe ato të volejbollit. Më pas, kur u krijua liceu artistik, muzika u shkëput prej këtij dhe shkoi te liceu artistik, që përfshin edhe arsimin e mesëm artistik. Tashmë shkolla nr. 1 ka mbetur shkollë 9-vjeçare. Sot është shkolla më e vjetër dhe më e madhe në qytet, që po arrin gradualisht numrin e 1500 nxënësve.

Ju i shikoni vetë ndryshimet që ka kjo shkollë, në sajë të pasionit të vetë mësuesve dhe të kolektivit pedagogjik, që me pasion dhe me dashuri bëjnë gjëra të bukura për t’i afruar nxënësit, që vijnë me dëshirë te kjo shkollë. Prindërit ofrohen vetë për të ndihmuar në këtë shkollë. Karakteristikë e kësaj shkolle dhe e kolektivit pedagogjik të saj, është bashkëpunimi

shumë i mirë me komunitetin prindëror. Pra, këtu funksionojnë shumë mirë marrëdhëniet e shkollës me bordin e prindërve dhe, nëpërmjet tij, me të gjithë komunitetin e prindërve që ka shkolla. Këtu ka vërtet gjëra shumë të bukura. Shkolla ka bërë binjakëzim me shumë shkolla jashtë vendit, si me një shkollë në Firence, në kuadër të projektit “Shkolla e gjelbër”, për të krijuar një mjedis të gjelbër, të dashur dhe paqësor për nxënësit, përveç investimeve në infrastrukturë, që janë bërë thjesht dhe bukur, që të grishin vërtet që të vish dhe të arsimohesh te kjo shkollë.

Prindërit kërkojnë që të çojnë fëmijët te shkolla “Andon Xoxa”, por ata kërkojnë që edhe shkollat e tjera të bëhen si shkolla “Andon Xoxa”.

Nëse do të shohim edhe shkollat e tjera, si shkolla nr. 2 “Penelopi Piro”, shkolla nr. 3 “Mark Dashi”, shkolla nr. 4 “Liri Gero”, secila prej tyre ka të veçantën dhe specifikën e vet.

Ne kemi çuar në qeveri projektet për rikonstruksionin e shkollës nr. 4 “Liri Gero”, sepse vetëm ajo na ka mbetur pa rikonstruktuar. Shpresojmë shumë që, megjithëse për këtë do t’ju flasë vetë kryetari i bashkisë, do të mundësohet investimi edhe për këtë shkollë. Tashmë kemi thithur investimet për shkollën “Penelopi Piro” dhe për shkollën në Libofshë.

Në Fier kemi edhe gjimnazin “Janaq Kilica”. Unë nuk e di se për cilën shkollë të Fierit t’ju flas më parë. Kur sheh ndryshimet në infrastrukturë, ato ndikojnë edhe te procesi mësimor dhe edukativ, pra shohim se reforma ka dhënë rezultatet e saj.

Përveç kësaj, ne do të shohim edhe investimet që janë bërë te teatri i qytetit të Fierit, “Bylis”. Faktikisht, është punuar për sallën e teatrit, që ajo të jetë në standarde bashkëkohore, sepse në fakt ishte e degraduar. Ka përfunduar salla. Po punohet me aspirimin, me sistemin e ngrohje-ftohjes dhe së shpejti, në datën 30 prill, do të përurojmë sallën e re me shfaqjen, në skenën e re të teatrit të qytetit. Tashmë po punohet edhe me fasadat, pra, teatri i qytetit është drejt përfundimit.

Përveç tij, do të shkojmë te galeria e qytetit, ku kemi një mini-mini Luvër, sepse kemi bërë një piramidë të vogël prej xhami. Poshtë piramidës zbret disa shkallë për të shkuar në një sallë të vogël kinemaje, ku të rinjtë mund të shohin ndonjë film mbrëmjeve, për ta kaluar kohën në mënyrë të kulturuar. Ajo sallë nuk ka shumë vende, 50-60 vende, por edhe kështu e kryen shumë mirë funksionin e saj. Është një gjë shumë e bukur. Kjo ishte ide e Kryetarit të Bashkisë. Në qendër të saj është ish-fabrika e miellit, që i jep identitetin qytetit të Fierit e që është një ndërtim i viteve ‘20 të shekullit të kaluar. Kjo ish-fabrikë mielli në mes të një sipërfaqeje prej rreth 3 dynym, për të cilën mund të them se ishte një plehrë e qytetit, ku ishin grumbulluar mbeturinat e tij, me një projekt madhor të mbështetur nga qeveria

shqiptare, u kthye në parkun më të madh të qytetit dhe kjo godinë e vjetër e ish-fabrikës së miellit, nuk u prish, por në katin e sipërm të saj u bë galeria e arteve.

Unë ju falënderoj që ishit në Fier!

Më pas, Komisioni u ndal në Parkun Arkeologjik të Apollonisë, ku u prit dhe u shoqërua nga nëndrejtori i Parkut, z. Arian Dhimo, i cili bëri një historik të përmbledhur të qytetit antik dhe dha shpjegime të hollësishme të rrënojave të tij, duke udhëhequr vizitën në Buleterion, Harkun e Triumfit, Odeonin, Obeliskun, Shëtitoren, Akropolin etj.. Vizita vijoi në Manastirin mesjetar të Parkut, ku gjendet që prej vitit 1985 edhe Muzeu Arkeologjik, në të cilin pasqyrohet një koleksion i pasur, që vjen nga gërmime të periudhave të ndryshme. Gjithashtu, ai shpjegoi dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut.

Komisioni e mbylli vizitën e tij në Manastirin e Ardenicës.

MBYLLET MBLEDHJA